

GJYKIMET PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

(KORRIK - DHJETOR 2024)

PËRMBAJTJA

- | GJYKIMET NË PROCEDURËN PARAPRAKE
- | GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË (SHQYRTIMI KRYESOR)
- | PROCEDURA NË SHKALLËN E DYTË – GJYKATA E APELIT
- | PËRFUNDIMI I DËNIMIT ME BURG

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) në vazhdimësi i monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK). Publikon buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara, të cilat i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informatat e përgjithshme mbi ecurinë e gjyqësorisë para DHSK përgjatë periudhës gjashtë mujore korrik - dhjetorë të vitit 2024.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar pesë (5) raste: Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerë; Prokurori kundër Pjetër Shalës; Prokurori kundër Salih Mustafës; Prokurori kundër Sabit Januzit dhe të tjerë; Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerë (administrimi i drejtësisë).



GJYKIMET NË PROCEDURËN PARAPRAKE

Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerë (administrimi i drejtësisë)

Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu and Hajredin Kuçi akuzohen sipas aktakuzës së konfirmuar të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të datës 6 dhjetor 2024. Më 5 dhjetor 2024, Isni Kilaj, Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu u arrestuan nga ZPS dhe u transferuan një ditë më pas në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) në Hagë. Po ashtu, Hashim Thaçit iu dorëzua fletarrestimi më 5 dhjetor, ndërsa Hajredin Kuçit iu dorëzua fletëthirrja për paraqitjen e tij të parë.

Sipas aktakuzës rreth periudhës kohore 12 prill 2023 deri më 2 nëntor 2023, gjatë vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit, Hashim Thaçi u dha Smakajt, Kilajt, Fazliut dhe Kuçit informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë të ZPS-së, udhëzime për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe hollësi se si duhej ta bënin këtë. Në aktakuzë gjithashtu pretendohet se Thaçi bashkërendoi tri grupe të veçanta, të formuara me Smakajn, me Fazliun dhe me Kilajn, së bashku me persona të tjerë që nuk janë akuzuar, si dhe Kuçin, me synimin për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në kontekstin e gjykimit aktual për krime lufte Thaçi dhe të tjerë.

- Thaçi, Smakaj, Kilaj dhe Fazliu akuzohen të kenë kryer veprën penale tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

- Thaçi, Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi akuzohen për kryerjen e veprës penale mosbindje ndaj gjykatës.

- Përveç kësaj, Thaçi akuzohet gjithashtu edhe për kryerjen e veprës penale shkelja e fshehtësisë së procedurës.

Gjatë paraqitjes së tyre të parë më 8 dhjetor 2024, Thaçi dhe Smakaj nuk deklaruan në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, ndërsa Fazliu u deklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Një ditë më pas, më 9 dhjetor, Kuçi dhe Kilaj gjithashtu u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat ndaj tyre.

Smakaj, Kilaj dhe Fazliu i është caktuar masa e paraburgimit kurse Kuçi mbrohet në liri.

Rasti është ende në procedurën paraprake.

GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË (SHQYRTIMI KRYESOR)

Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerë

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të gjithë me pozita të larta në UÇK, akuzohen nga Prokuroria për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit, për periudhën prej marsit të vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999, në disa lokacione në Kosovë dhe në Shqipëri, të cilat pretendohet të jenë kryer nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime. Të gjithë të akuzuarit gjenden në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020.

Në fillim të muajit prill të vitit 2023 ka filluar shqyrtimi kryesor me paraqitjen e fjalëve hyrëse të palëve në procedurë dhe që atëherë gjykimi ka vazhduar intenzivisht me dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria.

Gjatë periudhës korrik - dhjetor të vitit 2024, janë mbajtur gjithsej 57 seanca gjyqësore, ku janë dëgjuar 36 dëshmitarë të propozuar nga prokuroria. Që nga fillimi i procesit gjyqësor deri në fund të vitit 2024 janë dëgjuar gjithësej 110 dëshmitarë të propozuar nga prokuroria.

Në mesin e këtyre dëshmitarëve 19 prej tyre kanë qenë dëshmitarë të mbrojtur, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë dhe dëshmitë e tyre janë mbajtur kryesisht në seanca private, 17 dëshmitarët e tjerë kanë dëshmuar me identitet të zbuluar dhe në seanca të hapura për publikun. Në mesin e këtyre dëshmitarëve ka pasur dëshmitarë të cilët kanë qenë viktime ose kanë pasur njohuri për ndonjë rast që ndërlidhet me aktakuzën, dhe të njëjtit kanë dëshmuar për strukturat organizative të UÇK-së si dhe për qendrat e ndalimit në zona të caktuara. Mes tyre kishte edhe ish pjetarë të niveleve të ndryshme të organizimit të UÇK-së, duke përfshirë komandatë të zonave, brigadave dhe njësive.

Më 21 gusht 2024, sipas kërkesës së të pandehurit Kadri Veseli dhe avokatit të tij, Ben Emmerson, trupi gjykues miratoi kërkesën e tyre dhe vendosi të ndërpresë përfaqësimin e avokatit Emmerson për Kadri Veselin. Më 22 gusht 2024, u emërua avokati Rodney Dixon si avokat kryesor për Veselin. Ndërprerja e përfaqësimit të Emmerson ka ardhur si rezultat i "një prishjeje të pakthyeshme në marrëdhënien avokat-klient".

Shqyrtimi kryesor do të vazhdojë më 13 janar 2025 me dëgjimin e dëshmitarëve të radhës të propozuar nga prokuroria.

Prokurori kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit & Haxhi Shalës

Pas arrestimit nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari u transferuan në njësinë e paraburgimit të DHSK-së në Hagë në 6 tetor 2023, ndërsa Haxhi Shala u transferua më 12 dhjetor 2023.

Më 13 dhjetor 2023 ZPS-ja parashtrroi kërkesën për bashkimin e çështjes kundër Januzit dhe Bahtijarit me çështjen kundër Haxhi Shalës. Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e ZPS-së për bashkimin e këtyre dy çështjeve më 8 shkurt 2024. Më 27 shkurt 2024 ZPS dorëzoi aktakuzën e bashkuar, të cilën më vonë e ridorëzoi më 8 korrik 2024 duke përfshirë pretendimet e reja faktike vetëm për Januzin dhe Bahtijarin.

Sipas aktakuzës së konfirmuar, "Dëshmitari 1" është një individ që ka dhënë informacion, ose ka shumë gjasa ta bëjë këtë, për Task Forcën Hetimore Speciale, Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS), ose Trupin Gjykues të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) për krime ose vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së. Aktakuza përcakton se, ndërmjet datave 5 prill 2023 dhe 12 prill 2023, Shala, Januzi dhe Bahtijari, në bashkëpunim me persona të tjerë ndikuan tek "Dëshmitari 1".

Më tej, aktakuza specifikon se, me urdhër të Shalës, Januzi dhe Bahtijari zhvilluan takime individuale me "Dëshmitarin 1" në dy raste të veçanta për ta nxitur që të tërhiqte dëshminë ose të refuzonte të jepte dëshmi në procedurat zyrtare para DHSK-së, duke përdorur kërcënime serioze dhe duke bërë premtime për përfitime.

Duke kryer kështu veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare si dhe veprën penale të friksimit gjatë procedurës penale.

Më 4 shtator 2024 çështja kaloi tek trupi gjykues.

Më 18 dhe 19 dhjetor janë mbajtur seancat për marrëveshjet për pranimin e fajësisë, ku të tre të akuzuarit u deklaruan fajtorë lidhur me pikat 2 dhe 3 të aktakuzës së konfirmuar.

Trupi gjykues aktualisht është duke shqyrtuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë në këtë çështje dhe do ta nxjerrë vendimin në kohën e duhur.

PROCEDURA NË SHKALLËN E DYTË – GJYKATA E APELIT

Prokurori kundër Salih Mustafës

Salih Mustafa, komandant i njësitit BIA të UÇK-së, është gjykuar për krimet e luftës, të cilat i ka kryer gjatë muajit prill të vitit 1999 në fshatin Zllash/Zlaš të Komunës së Prishtinës/Priština.

Në datën 16 dhjetor të vitit 2022, Dhoma e shkallës së parë e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 26 vite burgim për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Në datën 6 prill të vitit 2023, trupi gjykues lëshoi urdhër për zhdëmtim të viktimave, ku kërkohet të paguhet shuma prej 207.000 € si kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të krimit.

Kolegji i apelit me aktgjykimin e shpallur me datë 14 dhjetor 2023 i rrëzoi gati të gjitha pikat e ngritura në ankesën e parashtruar nga mbrojtja e Mustafës. Duke filluar nga epiteti i konfliktit jondërkombëtar, provat që janë përdorur në gjykim, ligjit më të favorshëm penal, deklaratat e dëshmitarëve, elementi i vrasjes së paligjshme, ndalimi arbitrar e deri te alibia. Pra, të gjitha ankesat e mbrojtjes janë rrëzuar, me përjashtim të pranimit të pjesërisht të pikave 9F, 9H dhe 9K të dosjes së Apelit. Sipas kolegjit, shkelja e vetme në vendimin e shkallës së parë ka qenë lartësia e dënimit. Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit zvogëloi dënimin e Mustafës nga 26 në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Më 14 mars 2024 Mbrojtja e Salih Mustafës dorëzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme. Paneli i Gjykatës Supreme me datë 29 korrik 2024 miratoi pjesërisht kërkesën e Mustafës dhe anuloi pjesën e aktgjyimit të Apelit që kishte të bënte me dënimin e Mustafës me 22 vjet burgim, dhe e ktheu çështjen në Kolegjin e Apelit vetëm sa i përket pikës së lartësisë së dënimit.

Më 10 shtator 2024 Kolegji i Apelit pas vendimit të Gjykatës Supreme për ri-shqyrtimin e dënimit, shqiptoi dënimin prej 15 vitesh, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim. Kolegji i Apelit në vendimin e saj ka ulur dënimin e shqiptuar ndaj Mustafës duke ri-konstatuar ligjin më të favorshëm për të pandehurin, respektivisht Kodi Penal i Republikës së Kosovës të vitit 2019, dhe duke pasur në konsideratë praktikën e mëparshme gjyqësore për vepra penale të ngjashme.

Mbrojtja e Mustafës ka dorëzuar një kërkesë të dytë për mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme me datë 9 dhjetor 2024, duke iu referuar pikës 4 të aktakuzës e cila ka të bëjë me vrasjen. Sipas kësaj kërkesë mbrojtja e Mustafës kërkon uljen e dënimit prej 15 vjet burgim, në veçanti kërkon ose uljen e dënimit për Pikën 4 ose anulimin e vendimit, tërësisht ose pjesërisht, duke u bazuar në ligjshmërinë e gjyimit.

Gjykata Supreme ende nuk ka vendosur lidhur me këtë kërkesë.

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Pjetër Shala, pjesëtar i UÇK-së, akuzohet nga Prokuroria për krime të luftës për periudhën midis 17 majit të vitit 1999 dhe 5 qershorit të vitit 1999, kundër personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës/Kukeš, Shqipëri. Pjetër Shala vazhdon të mbetet në paraburgim që nga arrestimi i tij në mars të vitit 2021.

Sipas aktakuzës, pretendohet se midis 17 majit dhe 5 qershorit të vitit 1999 Pjetër Shala dhe disa ushtarë, policë e roja të UÇK-së patën të njëjtin qëllim të përbashkët të marrjes në pyetje dhe keqtrajtimit të të ndaluarve. Sipas aktakuzës, viktimat e këtyre krimeve ishin të gjithë shtetas të RFJ-së dhe persona të cilët nuk merrnin pjesë aktive në luftë.

Gjykimi në shkallën e parë ndaj Shalës ka filluar më 21 shkurt 2023 dhe zgjati deri më 17 prill 2024. Gjatë këtij procesi gjyqsorë kanë dëshmuar 10 dëshmitarë të propozuar nga ZPS, 2 dëshmitarë të propozuar nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar, dhe 10 dëshmitarë të propozuar nga ana e mbrojtjes së Shalës. Pjesëmarrës në këtë çështje ishin 8 viktima.

Në datën 16 korrik 2024, trupi gjykues shpalli Pjetër Shalën fajtor për krimet e luftës, përfshirë ndalimin arbitrar, torturën dhe vrasjen e paligjshme, dhe e dënoi me 18 vjet burgim. Ndërkaq, më 29 nëntor 2024, trupi gjykues shqiptoi urdhrin për zhdëmtimin e viktimave, duke urdhëruar të pandehurin të paguaj një shumë prej 208.000 € si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material që iu shkaktua viktimave të krimeve për të cilat ai u shpall fajtor.

Mbrojtja e Shalës ka dorëzuar ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër aktgjyqimit të shkallës së parë, për të cilën, deri në fund të vitit 2024, ende nuk është marrë vendim nga shkalla e dytë.

PËRFUNDIMI I DËNIMIT ME BURG

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë gjykuar për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Në datën 18 maj të vitit 2022, trupi gjykues i shpalli fajtor të dy të akuzuarit për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe dënoi secilin të akuzuar me nga katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe gjobë prej 100 eurosh për secilin.

Pas apelimit të vendimit të shkallës së parë nga mbrojtja e të pandehurve, Gjykata e Apelit në datën 2 shkurt të vitit 2023 e shpalli aktgjykimin dënues dhe i dënoi me katër (4) vjet e tre (3) muaj burgim dhe gjobë prej 100 eurosh. Ky është vendim i formës së prerë.

Në fillim të muajit maj të vitit 2023, mbrojtja e të pandehurve dorëzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme. Në datën 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pas modifikimit të dënimeve të tyre nga Kryetarja e DHSK-së, Gucati dhe Haradinaj u liruan me kusht më 17 tetor dhe 14 dhjetor 2023.

Duke u bazuar mbi 'Vendimin mbi Modifikimin e Dënimit' të 12 dhjetorit 2023, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kan përfunduar vuajtjen e dënimit me datë 24 dhjetor 2024.


Gjetjet e FDHK:

- Një aspekt pozitiv në procesin gjyqësor kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve (krime lufte) është përpjekja për ekonomizim të procedurës. Gjatë kësaj periudhe, janë pranuar si të lexuara dhjetëra deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria, të cilët nuk do të dëgjohen personalisht në shqyrtimin kryesor. Ky veprim ka kontribuar në përshejtimin dhe efikasitetin e procesit gjyqësor.

- Pavarësisht se Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) janë krijuar kryesisht për gjykimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera gjatë periudhës 1998-2000, deri në fund të vitit 2024, gjashtë (6) persona janë akuzuar për krime lufte dhe dhjetë (10) persona për pengimin në administrimin e drejtësisë ose ndikim tek dëshmitarët. Ky fakt tregon se dëshmitarët shpesh ndihen të pasigurt gjatë dhënies së dëshmive të tyre, për shkak të përpjekjeve për të ndikuar në to. Kjo gjendje konfirmohet edhe nga nevoja për të siguruar masa mbrojtëse për një numër të konsiderueshëm dëshmitarësh.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit “Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë” nga organizata “National Endowment for Democracy” përmes projektit të quajtur “Promovimi i Drejtësisë Tranzicionale, Dialogut dhe Kuptimit të Historisë”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës “National Endowment for Democracy”.



Federal Department of Foreign Affairs FDFA

